



RIPËRTËRITJA E QENDRAVE HISTORIKE
DHE ZHVILLIMI I TYRE I INTEGRUAR

IDEASS KUBE

Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug - Jug

Presentacion

**Teksti i shkruar nga Patricia Rodríguez Alomá
Fotot marre nga fondi i Master Planit dhe i Miguel Bàez**



Qyteti i Havanës i krijuar në fillimin e shekullit të 16-të, hijeshohet nga një pasuri e mrekullueshme e trashëguar e përbërë nga monumente urbane dhe arkitekturale që gjenden në qendrën e tij historike. Për shkak të evolucionit të qytetit gjatë një shekulli e gjysëm të fundit ai u kthye në një zonë të marginalizuar, dhe për disa dekada ai karakterizohej nga një prishje e dukshme e ndërtesave të saj, zëvendësimi i vlerave kulturore me të kundërtën e tyre dhe kushte të dobëta banimi në përgjithësi.

Restaurimit të qendrës historike të Havanës i është dhënë një shtytje e jashtëzakonshme me zbatimin e një modeli të ri menaxhimi të krijuar në vitin 1993 — në mënyrë paradoksale, në kontekstin e krizës më të rëndë ekonomike që vendi ka kaluar ndonjëherë — i cili nuk lë pas dore përgjegjësinë publike për mbrojtjen e trashëgimisë

kombëtare. Ai mbështetet në kulturë si parimi kryesor i tij dhe e vendos qenien njerëzore në qendër të tërë procesit — si krijuese, transportuese dhe transmetuese e modeleve kulturore dhe në këtë mënyrë si protagoniste të zhvillimit. Këtij vizioni socio-kultural të ripërtëritjes iu shtua një perspektivë ekonomike duke përdorur kriterin e përfitimit, e cila synonte që procesi të gjente vazhdimësi.

Modeli është zbatuar nga njësia vendase e quajtur Zyra e Historianëve të Qytetit të Havanës, në njohje të historisë së tij të vjetër dhe përvojës në zonat me trashëgimi kulturore. Institucioni i themeluar në vitin 1938, është një pioner në transformimin dhe ruajtjen e trashëgimisë dhe identitetit kombëtar. Ajo ka qenë e lidhur gjithmonë ngushtë me të gjitha proceset e ruajtjes së pasurisë së tundshme dhe të patundshme dhe ka kaluar përmes skenareve të ndryshme politike dhe socio-ekonomike, në të cilat ka mbrojtur gjithmonë rolin e saj si një pararojë intelektuale. Zyra ka mbajtur një angazhim të përhershëm me Shtetin dhe ka arritur rezultate të rëndësishme në punën e saj.

Në historinë e përvojës së gjatë të Zyrës që udhëhiqej fillimisht nga Dr. Emilio Roig de Leuchering, historian i qytetit të Havanës që nga themelimi i saj deri në vitin 1964 dhe më pas nga Dr. Eusebio Leal Spengler, që ishte krijuesi dhe nxitësi i një vizioni humanist dhe revolucionar për ripërtëritjen e trashëgimisë kulturore të Kubës. Dhjetë vitet e fundit Zyra, me një ekip bashkëpunëtorësh, ka zhvilluar dhe zbatuar kritere shumë të reja drejtimi. Dr. Eusebio Leal Spengler është nderuar me titullin “Ambasador i Vullnetit të mirë të Shteteve të Bashkuara”.

Ripërtëritja ekonomike dhe sociale, e lidhur ngushtë me ruajtjen e trashëgimisë, ka rëndësi strategjike përsa i përket zhvillimit njerëzor. Të kuptuarit e këtyre tre dimensioneve si një e tërë garanton përfshirjen e qytetarëve në proces. Me riaktivizimin e ekonomisë lokale me anë të kësaj perspektive, krijohen vende të reja pune, përmirësohen kushtet e jetesës dhe përmirësohet situata e varfërisë së tejskajshme, duke e zëvendësuar atë me një ripërtëritje të fuqishme që ka një ndikim pozitiv shumëfishues mbi investimet, duke zgjeruar zonat e fuqizuara dhe duke shtuar burimet e vlefshme për zhvillim.



Që kur mekanizmat e reja të drejtimit u vunë për herë të parë në zbatim e, deri tani Zyra ka nxjerrë 130 milion USD të cilët janë ri-investuar direkt në procesin e ripërtëritjes. Ky aktivizim i ekonomisë lokale ka mobilizuar më tej burimet e fondeve nga Banka Kombëtare, Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe buxheti i qeverisë, në parà kombëtare.

Puna është njohur pikësëpari nga të gjithë qytetarët dhe shteti i Kubës, siç e tregojnë studimet dhe vetë opinioni publik, të cilët i vlerësojnë pozitivisht rezultatet.

Përfitimi kryesor i siguruar është restaurimi në masën 33% i zonës së Qendrës Historike me mbështetjen e ekonomisë lokale, kryesisht të Shtetit, me rezultat krijimin në një shkallë të gjerë të vendeve të reja të punës. Korniza gjithëpërfshirëse e adoptuar lejon ri-investimin e burimeve të siguruara nga industria e turizmit dhe sektorë të tjerë të ekonomisë, me përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët. Havana e Vjetër mund të shihet si një laborator eksperimentues me një vizion të ri mbi mënyrën e menaxhimit të zonave historike.

Projekti ka siguruar gjithashtu një shkallë të lartë njohjeje ndërkombëtare, veçanërisht nga Sistemi i Kombeve të Bashkuara, në mënyrë të veçantë nga PNUD-i dhe UNESCO. Specialistët janë mbledhur në më tepër se 300 forume ndërkombëtare për të bërë më shumë të njohur zhvillimin e procesit në Qendrën Historike të Havanës.

Në vitet 2000-2003, përvoja e Zyrës së Historianëve u vlerësua me dhjetë çmime dhe nderime nga institucione prestigjioze ndërkombëtare.

Çfarë problemi zgjidh?

Zyra e Historianëve ka bërë të mundur të përballet dhe t'i gjejë zgjidhje pozitive problemit të restaurimit të Qendrës Historike të Havanës.

Zona me përparësi për ruajtje të vlerave përfshin 214 hektarë, me 3 344 ndërtesa, shumica e të cilave janë përfaqësuese shumë të çmueshme të shekullit të 18-të, 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të. Nga 514 ndërtesa me nivel mbrojtjeje të 1-rë dhe të 2-të, 32% janë në kushte teknike/ndërtimi të dobëta.



Ka një popullsi prej 66 745 banorësh dhe një tërësi prej 22 623 ndërtesash, 50% e të cilave janë të mbipopulluara dhe në kushte varfërie. Shumica e rrjeteve të infrastrukturës janë prishur ose mbingarkuar për shkak të vjetërsisë ose sepse janë jashtë funksionit.

Çdo tre ditë ndodhin dy shembje të një lloji apo të një tjetri në zonë dhe situata përkeqësohet gjatë stinës së cikloneve (pesë muaj të vitit). Sipas këtyre statistikave zona mund të konsiderohet subjekt i katastrofave të vazhdueshme me intensitet të ulët, ose praktikisht një zonë emergjence.

Zyra e Historianëve në praktikë

Qendra Historike është shpallur Monument Historik Kombëtar në vitin 1978 dhe që nga viti 1981 Shteti ka siguruar burime financiare të centralizuara për zonën, brenda buxhetit pesëvjeçar të ekonomisë kombëtare. Kjo situatë çoi në njohjen e saj në vitin 1982 si një vend i Trashëgimisë Kulturore Botërore, së bashku me sistemin e fortifikimeve që mbronin qytetin.

Me krizën ekonomike të shkaktuar nga rënia e bllokut socialist, Shteti mori një vendim të një rëndësie tepër të madhe për vazhdimësinë e punës restauruese: në vend që të vazhdonte me transferimin e burimeve financiare, ai i siguroi Zyrës së Historianëve të Qytetit të Havanës mjetet gjyqësore dhe financiare që do të garantonin zhvillim të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik. Rehabilitimi u shndërrua nga një aktivitet që subvencionohej nga qeveria qendrore në një proces fitimprurës që madje ndihmon Shtetin.

U identifikuan gjashtë kushte për garantimin e një ripërtëritjeje tërësore, të qëndrueshme dhe të vetëfinancuar: vullneti politik dhe vendim-marrja në nivelin më të lartë do të shoqëronin procesin; njohja e autoritetit të një "njësie drejtuese" të vetme për bashkërendimin e drejtimit të restaurimit (Zyra e Historianëve të Qytetit) dhe, ngritja e një kodi të veçantë ligjor që ndihmon njësinë të bëjë plane të integruara për zonën, e transferon në pronën e saj të patundshme në përdorim dhe lejon zhvillimin e një sërë mekanizmash për zbatimin e një ekonomie të decentralizuar.



Shpallja e Vendimit Ligjor nr. 143 (Tetor 1993) vendos këto të drejta të veçanta për Zyrën e Historianëve:

- vartësi direkte nga qeveria Qendrore;
- status ligjor;
- mundësia e zbatimit të politikave të veçanta të taksave për kontributet dhe rehabilitimin;
- krijimi i sistemit vetjak të menaxhimit për turizmin dhe sektorin terciar në përgjithësi;
- krijimi i Zyrës së Master Planit, një ekip ndërdisiplinor përgjegjës për planifikimin e integruar dhe drejtimin e zhvillimit të Qendrës Historike;
- zgjerimi i strukturës së saj për të ndjekur tërë vazhdimësinë e procesit.

Për të realizuar zhvillimin e modelit Zyra ka specializuar burime njerëzore, duke krijuar dhe përforcuar një strukturë organizative me departamente dhe drejtorë të veçantë si dhe një sistem drejtimi. Kjo strukturë është në gjendje të udhëheqë procesin nga planifikimi i integruar strategjik — mjedisor në kuptimin më të gjerë (ekonomi-shoqëri-territor-banesë) — përmes restaurimit fizik të ndërtesave dhe hapësirave urbane, duke përfshirë organizimin dhe zhvillimin e procesit të investimit që e garanton atë dhe mundësinë e administrimit të bashkëpunimit ndërkombëtar.




Proçesi i rehabilitimit është ndërtuar duke bashkërenduar konceptet e politikës së zhvillimit të integruar me mekanizmat e ripërtëritjes nga vetëfinancimi dhe zhvillimit kulturor, siç është bërë e njohur në Planin e Zhvillimit të Integruar. Plani përfshinte pesë politika kryesore:

- Ruajtjen e identitetit kombëtar përmes kërkimit, nxitjes dhe zhvillimit të kulturës.
- Mbrojtjen e trashëgimisë, duke restauruar zonën në bazë të një Plani Zhvillimi të Integruar të vazhdueshëm dhe me mjete ligjore. Ky Plan është konceptuar si një “hartë lundrimi” dhe si një tërësi menaxhimi nga të gjithë dhe instrumentesh planifikimi që bëjnë, mbi të gjitha, të efektshëm drejtimin e procesit.
- Shmangien e shpërnguljes së popullsisë lokale, duke e mbrojtur atë nga ndikimi i transformimit dhe duke siguruar nivele të mjaftueshme të banimit dhe të cilësisë së jetesës.
- Pajisjen e zonës me shërbimin e infrastrukturës teknike dhe themelore që garanton funksionimin e saj në përputhje me kërkesat bashkëkohore.
- Arritjen e zhvillimit të integruar të vetëfinancuar që e bën investimin një trashëgimi të rikthyeshme dhe produktive.

Në të njëjtën kohë, Zyra është në gjendje të zhvillojë një program të fuqishëm socio-kulturor dhe ekonomik si një mënyrë për nxitjen e zhvillimit njerëzor në kuptimin më të gjerë. Më në fund, kjo strukturë garanton gjithashtu administrimin e turizmit, pasurive të patundshme dhe sektorëve terciarë për të siguruar burime financiare. Këto institucione janë të organizuar në katër grupe që sigurojnë: përputhje me politikat e paraqitura në Planin Special të Zhvillimit të Integruar dhe zbatimin e tyre; kuader socio-kulturor; përvetësimin dhe administrimin e burimeve financiare dhe rehabilitimin fizik.

Harta Organizative



Plani i zhvillimit të integruar përcaktoi gjithashtu dhjetë strategji thelbësore për punimet në zonë, që janë në përputhje me politikat e përmendura më sipër. Këto politika dhe strategji u vunë në praktikë përmes zbatimit të Planit të Investimeve dhe programeve socio-kulturore, të organizuara nga Zyra e Historianëve.

- **RESTAURIMI I TRASHËGIMISË STRUKTURORE URBANE**, qëllimi kryesor i të cilit është të përqëndrojë restaurimet në zonat me potencial të madh, duke zgjeruar aktivitetin sipas burimeve në dispozicion; restaurimi i akseve terciare dhe zonave urbane kufitare që kanë prioritet më të lartë; zhvillimi i pikave kryesore të veçanta si fuqizuese të procesit brenda zonës urbane ndërkohë që caktohen burimet për rastet specifike që janë të veçanta për shkak të rëndësisë ose domosdoshmërisë ekonomike.
- **FORCIMI I ZHVILLIMIT KULTUROR** në bazë të studimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore, arkeologjike dhe artistike dhe zhvillimi e përhapja e saj; ndihmesa në ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e asaj trashëgimie nga komuniteti i Qendrës Historike dhe popullsia në përgjithësi, përmes programimit kulturor; propagandimi i punës së Zyrës së Historianëve në restaurimin dhe ruajtjen e trashëgimisë; vazhdimi i tregtimit të produkteve kulturore më autentike, duke ndihmuar në të njëjtën kohë në mbështetjen e detyrave për restaurimin dhe ruajtjen e objekteve muzeale.



- **ZHVILLIMI I EKONOMISË Lokale** duke u mbështetur në nxitjen e efikasë të burimeve të trashëgimisë, modifikimi gradual i strukturës ekonomike; forcimi i aktiviteteve ekonomike që ndihmojnë në zhvillimin e territorit; zhvillimi i aktiviteteve dhe sektorëve të rinj; mundësimi i një ekonomie lokale heterogjene dhe shtimi i burimeve të fondeve.
- **FORCIMI I FUNKSIONEVE TERCIARE** që përfshin zonat e turizmit, pasuritë e patundshme dhe shërbimet

metropolitane, për garantimin e një industrie turizmi me kriterë rigorozë përzgjedhjeje dhe mbështetjeje; vlerësimi në kohën e përshtatshme të ndërlitimeve të asimilimit dhe zgjerimit të turizmit të lundrimit; dhënia e përparësi planeve të zhvillimit në sektorin e pasurisë së patundshme dhe nxitja e restaurimit të shërbimeve të ndryshme që shquatin Qendrën Historike dhe që i jepnin asaj karakterin shumëfunktional, hierarkik dhe shumë të kualifikuar

- ZGJIDHJA E PROLEMEVE TË STREHIMIT me anë të programeve për përmirësimin e zonave të banimit duke përdorur një plan të menaxhueshëm; përcaktimi i një modeli ndërhyjeje për mjediset e banimit; projektimi i programeve për mjedisin me karakter social dhe gjithëpjesëmarrës; krijimi i një organizate të decentralizuar produktive të veçantë që t'u përgjigjet në mënyrë të plotë programeve të banimit në praktikë. Shtimi i burimeve të financimit që marrin përsipër zbatimin e programeve, vendosja e një racionalizimi maksimal dhe kontrolli i burimeve të materialeve teknike si dhe perfeksionimi i mekanizmave ligjore që rregullojnë proceset e rregullimit të strehimit.
- NËXTJA E REHABILITIMIT GJITHËPJESËMARRËS që nxit popullsinë vendase për të marrë pjesë aktive në planifikimin e tij. Paraqitja e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të komuniteteve jozyrtare; favorizimi i bashkëmenaxhimit të proceseve dhe fillimi i një banke idesh që përfshin projektet e mundura.
- ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE PËR MJEDISIN E BANIMIT (mjetet e komunitetit) që arrijnë kushte të shkëlqyera dhe shpërndarje të mjaftueshme të qendrave të të mësuarit; paraqitja e veprimeve që lejojnë përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, sigurojnë shpërndarje të mjaftueshme në terren dhe nxisin një kulturë shëndetësore përmes mjeteve alternative. Në të njëjtën kohë, plani shërben për rigjallërimin e rrjetit tregtar dhe shërbimeve të përgjithshme të territorit, njëherësh në numrin e lokaleve dhe shërbimet që ata ofrojnë; përforcimi i strukturës organizative për higjienën e Qendrës Historike dhe sigurimi i pajisjeve të nevojshme për kryerjen e kësaj detyre; stimulimi i popullsisë në pjesëmarrjen e aktiviteteve kulturore dhe në pajisjen me sheshe sportive funksionale, të gjitha në bashkëpunim të ngushtë me Qeverisjen Bashkiake.



- Përmirësimi i rrjeteve të infrastrukturës i analizuar nga perspektiva të ndryshme: infrastruktura e rrugëve kryesore do t'u përgjigjet nevojave të mjeteve të transportit, në përputhje me kategoritë funksionale të sistemit të kalimit të qytetit, duke vendosur masa në rrugët kryesore dhe dytësore për t`i dhënë përparësi kalimit të këmbësorëve; rrugët dytësore do të vazhdojnë të përsosën duke i kushtuar vëmendje të veçantë përmirësimit të kushteve teknike të trotuareve dhe të mjeteve për rregullimin dhe kontrollin e kalimit; parkimi duhet zgjeruar në mënyra të ndryshme për të kënaqur kërkesat; duhet përfunduar tërësia e sistemit të kalimit të qytetit; duhet organizuar mënyra sesi funksionon transporti i ngarkesave për të zvogëluar efektet negative që ai shkakton. Në sistemin ujor, planet kryesore janë për furnizimin përfundimisht të konsumatorëve me ujë të pijshëm nga rrjeti, duke eliminuar shërbimin e kamionëve çisternë aktualisht në përdorim; përmirësimi i sistemeve ekzistuese të kullimit të ujërave të shiut dhe ujërave të zeza; përfundimi i planit të gazit brenda territorit, për gazin e prodhuar; në sistemin elektrik, bërja më efiças e rrjetit të elektricitetit dhe zhvillimi i planit të ndriçimit. Për sistemet e dobëta aktuale, është e rëndësishme përsosja e shërbimit telefonik dhe zhvillimi i kabllove televizive.



- **ZHVILLIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR** me qëllim garantimin e një përdorimi më efikas të burimeve të bashkëpunimit; stimulimi i bashkëpunimit të decentralizuar përmes Programit Lokal të Zhvillimit Njerëzor, të sponsorizuar nga PNUD/UNOPS-i gjithçka u përmend më sipër në lidhje të ngushtë me Ministrinë e Investimeve të Huaja dhe Bashkëpunimit Ekonomik (MINVEC).
- **NXITJA E NJË KULTURE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT** që propozon një strategji të integritit metropolitan; mbrojtja e mjedisit urban, burimeve natyrore dhe diversitetit biologjik si pjesë e politikës së hartuar nga Ministria e Shkencave, Teknologjisë dhe Mjedisit; nxitja e menaxhimit të një sistemi transporti dhe tranziti më efikas dhe të mirëpritur; lehtësimi i menaxhimit të efektshëm për grumbullimin e mbeturinave të ngurta dhe për higjienën; nxitja e përdorimit të efektshëm të energjisë dhe në përputhje me udhëzimet e përpiluara nga Ministria e Industrisë Kryesore dhe Ministria e Shkencave, Teknologjisë dhe Mjedisit; përmirësimi i hapësirave ekzistuese dhe krijimi i atyre të reja në zonë dhe përmirësimi i shëndetit mjedisor dhe vëmendja ndaj grupeve të dobëta.



MASTER PLANI

Njësi ndër-disiplinore; zona pjesëmarrëse
Dikton politikat dhe strategjitë e zhvillimit.
“Harta e lundrimit”

PLANI I VEÇANTË PËR ZHVILLIMIN E INTEGRUAR

(Plani i dokumentuar)

- Plani Strategjik
- Plani për rregullimi territorial dhe urban
- Plani socio-ekonomik

ADMINISTRIMI I PLANIT

(Proçesi i Planit)

- Marrëveshja e planeve
- Kontrolli i territorit
- Shpërndarja e punës
- Bashkëveprimi dhe bashkëpunimi



Rezultatet



Shfrytëzimi i burimeve kulturore, të turizmit dhe atyre terciare në zonë ka prodhuar 120 milion USD fitime në tetë vjet. 12 milion USD janë grumbulluar përmes zbatimit të politikës fiskale. Decentralizimi ekonomik ka lejuar ri-investimin e menjëhershëm të këtyre burimeve në një koncept të derdhjes në kesh. Kjo ka nënkuptuar sigurimin e rezultateve shumë të dukshme në një kohë të shkurtër, të konkretizuar në ripërtëritjen urbane dhe sociale dhe si rrjedhojë një prodhim të të ardhurave pozitive që tërheq më shumë investim dhe interes, duke rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve dhe njerëzve që kërkojnë shërbimet në fjalë. Besueshmëria e vetë procesit ka bërë që Banka Kombëtare të sigurojë 60 milion USD në kredit të planifikuar për veprat e kushtueshme dhe që Shteti të sigurojë rreth 260 milion pesos nga buxheti qendror.

Zbatimi i politikave fitimprurëse për shoqërinë, me 35% të burimeve të parashikuara për punë sociale të tilla si ndërtim banesash, shëndetësi dhe arsim, ka mobilizuar gati 5 milion USD në bashkëpunimin ndërkombëtar që nga viti 1994.

Gjatë procesit janë krijuar 10 250 vende të reja pune direkte, 60% e të cilëve janë mbuluar nga banorët e Havanës së Vjetër ose të bashkive përreth dhe 34% nga gra, që zinin 59% të pozicioneve teknike. Është llogaritur se janë

SHPERNDARJA E BURIMEVE FINANCIARE

- Projekte që krijojnë burime financi
- Projekte dhe programe sociale
- Të tjera (kontribute për rezervat, urgjencat, kontribute për zonat e tjera të qytetit, etj)



krijuar rreth 2 000 vende pune indirekte, që kanë të bëjë kryesisht me restaurimin e ndërtesave, duke siguruar shërbimet dhe rigjallërimin e aktiviteteve të zejtarisë dhe prodhimit.


Shumë ndërtesa me përdorim social janë restauruar, kryesisht për përforcimin e arsimit të Administratës së Bashkisë dhe sektorëve të shëndetit.

Janë shfaqur eksperiencia të reja në sektorin e arsimit, përfshirë “klasat në muzeum”, duke u siguruar nxënësve hapësirë brenda institucioneve ku ata mund të zhvillojnë orët mësimore dhe alternativa të tjera kulturore ndërkohë që shkolla e tyre riparohet. U krijua një shtëpi e nënave me fëmijë, së bashku me një qendër rehabilitimi për fëmijët dhe një qendër për të moshuarit, ndërsa u pajisën zyrat e mjekëve dhe u restauruan më tepër se një duzinë qendrash shkollore. U intensifikua veprimtaria kulturore me shërbimin e më shumë se tridhjetë pajisjeve përfshirë muzeumet, shtëpitë muze, galeritë, sallat e koncerteve, katërbëdhjetë biblioteka të specializuara dhe qendra për fëmijët dhe të rinjtë, sheshe lojrash,

akuarium dhe qendra lojërash mes të tjerash. Po punohet për restaurimin banesave me rëndësi sociale, me një total prej gjashtë programesh që kanë siguruar përfitime të llojeve të ndryshme për një numër të madh banorësh.

Numri mesatar i veprimtarive të specializuara kulturore gjatë një viti është 800 koncerte me 70 000 spektatorë, 296 konferenca, 45 kurse për të rinjtë e fëmijët, 50 filma të shfaqur në ekran, 2 000 ekspozita të vizituara nga 170 000 vizitorë, 6 000 orë radio-transmetim, një program televiziv i përjavshëm me kohëzgjatje gjysëm orë dhe katër botime të periodikes Opus Habana, mes iniciativave të tjera.

TË ARDHURAT DHE PERFITIMET 1994-2002



	Përfitime	Të ardhura
1994	1813,0	4960,0
1995	4231,6	11558,0
1996	6971,8	23358,8
1997	10565,9	35309,5
1998	14832,1	45868,1
1999	18106,4	55208,5
2000	21272,9	66607,9
2001	20450,3	70299,0
2002*	10901,3	37700,9
ICR	10830,8	10830,8
TOTAL	119976,1	361701,5

*Semestri i parë
ICR: Ingreso por Contribucion a la Restauración

SHUMA TOTALE E INVESTIMEVE: 134.383,2 M USD prej të cilëve: 55923,5 M USD nga Banka Kubane e Kreditit dhe 256615,1 MP, të tjera nga buxheti i shtetit

KONTRIBUTI PËR REZERVAT: 23182,2 MUSD

Kjo politikë e krijimit të vendeve të reja të punës, duke mbështetur pjesët e administratës bashkiake iu bashkua një programi që siguron kujdes të specializuar ndaj grupeve të dobëta dhe një programi me cilësi kulturore dhe rikrijuese, duke dëshmuar prirjen sociale të programit. Ata përbëjnë një shembull që dëshmon sesi kriteret e biznesit të zbatuara në industrinë e turizmit dhe në sektorin terciar nuk janë në kundërshtim me zhvillimin njerëzor, duke pasur parasysh se kur pikënisja është zbatimi i politikave publike të drejtësisë sociale, mund të arrihen rezultate shumë inkurajuese.

Interesi Ndërkombëtar

Një analizë e ripërtëritjes së qendrave historike në rajon tregon se duke filluar nga viti 1990, disa projekte filluan të zbatonin modelet e drejtimit që përfshijnë perspektivën ekonomike dhe atë të përfitimit të ripërtëritjes së këtyre hapësirave urbane. Ndërsa në disa raste përvoja është zhvilluar me sukses, asnjë prej tyre nuk ka shfaqur avantazhe më të mëdha të krahasueshme për sa i përket natyrës tërësore të procesit, as përparime sasiore dhe cilësore, që mund të shihen sot në përvojën e Havanës së Vjetër.

Ka pasur gjithashtu njohje të rëndësishme nga komuniteti ndërkombëtar, të paraqitura nga një rritje e fuqishme e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në dhënien e një numri dekoratash dhe çmimesh nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare përfshirë:

- Konferenca Andrés Bello (Çmimi i v. 2000, Njohja 2002);
- Çmimi Ndërkombëtar i Dubait 2000 (Fletë Lavdërimi);
- Çmimi i Paqes së UNESCO-s (Fletë Lavdërimi 2000-2001);
- Çmimi i Arkitekturës Evropiane Philippe Rothier (Çmimi 2001);
- Çmimi Metropolis 2001 (Çmimi i Dytë);
- Çmimi Stockholm Partnerships Sustainable Cities, 2001 (Përvoja Finaliste);
- Shoqata për Menaxhimin e Qendrave Urbane, Valenzia (Çmimi 2002);
- Çmimi Kombëtar për Restaurimin dhe Ruajtjen (Çmimi 2002 për Ruajtjen);
- Çmimi i Fondacionit Mbretëror të Toledos (Prill 2003).

Në shqyrtim të rezultateve të siguruara nga Qendra Historike, zona e konsideruar “Përparësi për Ruajtje” është zgjeruar në Malecón Habanero, ndërsa pritet zgjerimi i zonave të tjera të qytetit.

Përvoja është adoptuar në situata të tjera të Kubës në qytetet e Santiago de Kuba, Trinidad, dhe Camagüey.

Shumë qytete kanë kërkuar këshilla nga Zyra dhe ndihmë nga specialistët e saj në Kubë. Bashkë me Meksikon, Zyra ka pasur një marrëdhënie të vazhdueshme me shtatë qytete të përcaktuara si qytete të Trashëgimisë Kulturore Botërore dhe ka marrë pjesë në dy këshillime me kërkesë të veçantë nga Qeveria e Qytetit të Meksikos. Kohët e fundit një mision i organizuar nga UNESCO në Brazil në të cilin të gjitha qytetet Braziliene të listës së Trashëgimisë Botërore u paraqitën dhe vizituan Zyrën për të filluar projektimin e sferave të punës së përbashkët. Qyteti i Panamasë (Panama), Tegucigalpa (Honduras), Ciudad Bolívar (Venezuelë), Cuenca (Ekuador), Valparaíso (Kili) dhe qytete të tjera kanë kontaktuar Zyrën për të shprehur interesin e tyre për të mësuar më tepër rreth metodologjisë së punës dhe në disa raste kanë zbatuar pjesë të përvojës. Drejtimi i modelit të përdorur për restaurimin e qendrës historike të Havanës është me të vërtetë i njohur në nivel rajonal dhe ka ngjallur shpresa të mëdha.



Adoptimi i metodologjisë së Zyrës në vende të tjera

Përdorimi i përvojës së Zyrës së Historianëve do të nënkuptojë gjithmonë, natyrisht, adaptimin e saj në kontekste të ndryshme. Por ka disa pika e strategji thelbësore që janë themelore dhe krejtësisht të transferueshme.

Duhet sqaruar se përdorimi i vetë metodologjisë kushton shumë pak, duke qenë se ai kërkon vetëm burime njerëzore të trajnuara dhe vullnet politik. Me këto faktorë si bazë, pjesa e mbetur është një çështje e krijimit të proceseve pozitive dhe lehtësimit i bashkimit të interesave që krijojnë të ardhura pozitive që tërheqin dhe nxisin investimet.

Nga ana tjetër, zbatimi i metodologjisë së Zyrës përforcon qeverisjen e qendrave historike- segmente delikate të qytetit- duke pasur parasysh këtë, rezultatet e përftuara ndihmojnë sigurimin e pesë aspekteve strategjike të qeverisjes së mirë:

- autonomia lokale
- sigurimi i vazhdimësisë së procesit
- rinovimi dhe sqarimi i kodit ligjor
- rregullimi i hapësirës publike
- aftësia për të planifikuar zhvillimin territorial në një formë tërësore.

Zyra është përpjekur të krahasojë disa nga këto pengesa në Qendrën Historike të Havanës me anë të zbatimit të modelit të drejtimit të përshkruar më sipër.

Për adoptimin e modeleve të ngjashme në kontekste të tjera, është i domosdoshëm një kusht: vullneti politik dhe vendim-marrja në nivelet më të larta. Ka arsye të peshës dhe përshtatshmërisë për shtetin-me përgjegjësinë më të lartë për mbrojtjen e trashëgimisë — të kujdeset dhe të mbështesë drejtimin e veçantë të qendrave historike. Në rastin kur një qendër historike është shpallur një vend i Trashëgimisë Kulturore Botërore, Shteti duhet të sigurojë mbrojtjen e tij.

Gjatë analizave të dinamikave të ndryshme rajonale për rigjallërimin e qendrave historike, kemi vënë re se procesi mund të hasë vështirësi për shkak të këtyre problemeve:

- Numri i madh i personave të përfshirë me përgjegjësi lokale ose kombëtare lidhur me trashëgiminë
- Natyra e ndërlikuar e përbërjes së tokës
- Legjislacion i vjetër dhe i jo i plotë
- Mungesa e vullnetit politik në nivelin më të lartë dhe kontradiktat mes nivelit lokal dhe kombëtar sipas interesave të partive politike
- Proces që varet nga personat e zgjedhur politik
- Plane të lidhura me periudhën e shkurtër elektorale
- Konfliktete të mprehta sociale dhe shtresat e varfëra
- Niveli i ulët ekonomik ose gjendja nën normën ekonomike e banorëve
- Krizat ekonomike kombëtare





Përveç kësaj, mbrojtja e qendrave historike është një punë komplekse që kërkon burime të mëdha për shkak të problemeve serioze të përqëndruara në këto zona, kushteve që përgjithësisht kufizojnë ndërhyrjen që mund të bëhet në to.

Ka gjithashtu një argument të fortë për klasifikimin e qendrave historike si zona të veçanta për t'u marrë përsipër: ata janë vazhdimisht të prirura ndaj kushteve të zonave me intensitet të ulët katastrofal dhe janë përgjithësisht zona konfliktuale nga ana shoqërore.

Këto vëzhgime nënkuptojnë që mund të jetë në interesin e administratave publike mbështetja e një procesi të qëndrueshëm rehabilitimi, që përmes vetëfiancimit dhe mekanizmeve vetëdrejtuese, mund të kthehet madje në një situatë të punës së subvencionuar që kontribuon përmes zhvillimit të një qyteti ose një kombi.

Puna rindërtuese nën udhëheqjen e autoriteteve drejtuese në sektorin publik ka qenë e sukseshme në Havanën e Vjetër dhe është një tjetër formulë e mundshme për t'u zbatuar në vendet e tjera. Institucioni duhet të jetë autonom dhe i njohur në nivelin më të lartë, nga i cili mund të parashikohet gjithashtu të raportojë në mënyrë periodike mbi punën e tij. Në të vepruarit në nivel lokal, marrëveshjet duhet të arrihen në nivel lokal me hartuesit kryesorë të politikave, strategjive dhe planeve, që duhen mbajtur të informuar mbi progresin e menaxhimit të projektit. Kjo garanton një punë transparente dhe të qëndrueshme në qendrën historike, të distancuar nga interesat specifike dhe mungesa e ndërgjegjjes që ekziston në disa kushte.

Të pasurit e një statusi ligjor është absolutisht diçka e nevojshme, një pikë tjetër kjo që duhet të kihet parasysh. Kërkohen norma të veçanta gjyqësore veçanërisht për lehtësimin e gjithçkaje që lidhet me përdorimin e tokës, të nxirret ligji mbi mundësinë e shpronësimit ose të blerjes së preferuar, kreditet me interesa të ulëta dhe me afat të gjatë shlyerje, etj. në favor të institucionit përgjegjës për restaurimin. Kjo i garanton atij financimin e kapitalit vetjak si kapital thelbësor që mund të rritet përmes përdorimit efikas. Një njësi publike mund të jetë pronari dhe

mund të administrojë, ose të nënkontrakttojë, ose të japë me qera asetet, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së procesit të ripërtëritjes, duke zbatuar politika fiskale dhe përdorimin e tokës të projektuar veçanërisht për secilin rast.

Gjithashtu mund të përfshihen mekanizma të veçantë të financës, që përveç mekanizmeve të përdorimit të tokës të përmendura më sipër, do të mund të shtonin mundësitë e ofruara nga mbivlera urbane, transfertën e burimeve të zhvillimit ose vendosjen e një sistemi të veçantë taksash, mes të procedurave të tjera.

Një pikë tjetër për t'u marrë në konsideratë është formimi i një ekipi ndërdisiplinor përgjegjës për projektimin e një Plani të Integruar të

Zhvillimit për t'u përpiluar së bashku me të interesuarit e tjerë, në qendrën historike, të cilat janë zyrat e ndryshme të administratës publike, institucionet publike/private dhe private ose shoqëritë dhe popullsia vendase. Plani, i pranuar nga të njëjtët persona të interesuar, bëhet "plan-punë" për administratorët. Zyra e planifikimit duhet të shërbejë si një hapësirë për zhvillimin e bisedimeve dhe përdorimin e strategjive që e bëjnë Planin të qëndrueshëm. Rëndësia e përfshirjes së planifikimit territorial brenda sistemit të këtij "autoriteti autonom" është thelbësore, ngaqë është sigurisht strategjike mundësia e të ndërvepruarit me truallin urban dhe përdorimet e truallit: duke ndërtuar kushte, krijimin e zonave, rritjen e qerasë urbane, prodhimin e të ardhurave pozitive.



KUSHTET TEKNIKE PËR ZBATIM

Për të zbatuar modelin e drejtimit të Zyrës, bashkësia e personave të përfshirë në ruajtjen e qendrës historike duhen identifikuar me qëllim gjetjen e zëdhënësve të përshtatshëm.

Hapi tjetër është zgjedhja e një “agjensie udhëheqëse” me autoritet të mjaftueshëm ligjor për të ndjekur procesin, me përgjegjësinë e lehtësimit dhe arritjes së marrëveshjeve, me përgjegjësit për trashëgiminë, përgjegjës për territorin dhe me autoritet për të marrë vendime në rastet kur marrëveshjet nuk mund të arrihen me anë të mekanizmave të vendosur.



Kjo agjensie duhet të përfshijë në themel katër elementë të specializuar:

- Master Plani. Vendos udhëzimet kryesore të zhvillimit të integruar, rregullon planet dhe programet, koordinon negociatat me players të ndryshëm, udhëheq studimet e mundshme dhe kërkon dhe financues të përbashkët.
- Zyra Qendrore. Vepron si një bankë që administron financat, pasuritë e patundshme, etj. burimet e agjensisë udhëheqëse.
- Zyra e Trashëgimisë Kulturore. Koordinon dhe zbaton kërkimet dhe programet kulturore dhe bën publicitet përmes mjeteve të informacionit dhe shtypit të specializuar çfarë ndodh në qendrën historike.
- Sistemi drejtues. Vetëm ose në shoqëri, krijon disa sektorë produktivë në industritë përkatëse kulturore dhe të turizmit, sektorin terciar, “ekonominë e njohjes dhe informacionit” dhe aktivitete të tjera produktive në përputhje me karakterin e qendrës historike.

Për të mësuar më tep

BIBLIOGRAFIA:

- Desafio de una Utopía (Sfida e Utopisë). 2002. Zyra e Historianëve të Qytetit të Havanës, Editoriali Boloña.
- Plan de Desarrollo Integral (Plani i Zhvillimit të Integruar). Dokumenti i Master Planit. Zyra e historianëve të qytetit të Havanës.
- Centros Históricos de América Latina (Qendrat Historike të Amerikës Latine). 2002. Ekuador, Editoriali FLASCO.
- Proyecto Gestión Integral del Patrimonio Cultural (Drejtimi tërësor i projektit të trashëgimisë kulturore). 2003 Zyra Rajonale e Kulturës për Amerikën Latine dhe Karaibet, UNESCO.



Kë të kontaktojmë?

Stafi teknik përgjegjës për drejtimin e veprimtarive të Zyrës është në gjendje të ofrojë ndihmë teknike në vendet e tjera të interesuara në adoptimin e përvojës.

Për më tepër informacion dhe për vendosjen e një bashkëpunimi të vazhdueshëm, kontaktoni:

Patricia Rodríguez Alomà, Arkitekte
Drejtoreshë e Master Planit për Rigjallërimin Tërësor të Havanës së Vjetër
Zyra e Historianëve të Qytetit të Havanës, Kubë

E-mail: patricia@planmaestro.ohch.cu

Adresa:
Plan Maestro. Oficina del Historiador de La Ciudad.
Empedrado 151 esquina a Mercaderes.
Plaza de la Catedral.
Habana Vieja. C.P: 10 100 – Kubë
Tel. (537) 860 43 11 – 14

Iniciativa IDEASS – Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug – Jug është promovuar nga programet e mëposhtme për bashkëpunim ndërkombëtar: ILO/Universitas, UNDP/APPI, dhe UNDP/ IFAD/UNOPS Programet për Zhvillim Njerëzor dhe Programet Kundër Varfërisë, aktualisht prezente në Shqipëri, Angola, Kolumbi, Kubë, El-Salvador, Guatemalë, Honduras, Mozambik, Nikaragua, Republikën Domenikane, Serbi, Afrikën e Jugut e Tunizi. Iniciativa e bashkëpunimit është rezultat i Samiteve Botërore në vitet 1990 dhe i Asamblesë së Përgjithshme të Mileniumit; ajo i jep përparësi bashkëpunimit mes protagonistëve në Jug, me mbështetjen e vendeve të industrializuara.

Qëllimi i IDEASS është të forcojë efektivitetin e proceseve të zhvillimeve lokale përmes përdorimit në rritje të inovacioneve për zhvillim njerëzor dhe kushte të mira pune. Përmes projekteve të bashkëpunimit jug-jug, ata veprojnë si një katalizator për përhapjen e inovacioneve sociale, ekonomike dhe teknologjike që favorizojnë zhvillimin ekonomik dhe social në nivel lokal. Inovacionet e promovuara mund të jenë produkte, teknologji, ose praktika sociale, ekonomike, ose kulturore. Për më tepër informacion rreth Inicativës IDEASS vizitoni faqen e internetit: www.ideassonline.org

IDEASS

Inovacione për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Jug - Jug



Programi i PNUD-it Inicativat e Partneritetit Kundër – Varfërisë (APPI) është një program i projektuar për të ndihmuar qeveritë dhe aktorët socialë për të vendosur dhe zbatuar politika kombëtare për uljen e varfërisë dhe përfshirimit social, bazuar në praktikën e zhvillimit të integruar dhe gjithëpërfshirës në nivel lokal.



Programet për zhvillim njerëzor dhe kundër varfërisë të zbatuara UNDP, IFAD, ILO, dhe UNOPS përkrahin proceset e zhvillimit lokal të integruar dhe gjithëpërfshirës brenda kuadrit të politikave kombëtare, me mbështetjen e aktoreve publikë, privatë, dhe shoqërisë civile. Këto programe sigurojnë kornizën brenda së cilës vendet dhuruese dhe komunitetet në vendet e industrializuara mund të bashkëpunojnë në mënyrë të organizuar, përmes bashkëpunimit të decentralizuar. Brenda këtij kuadri do të realizohen dhe bashkëpunimet jug – jug përmes Inicativës.



Programi ILO/Universitas (punë korrekte përmes trajnimit dhe inovacionit) inkurajon përdorimin e zgjidhjeve inovative të problemeve në zhvillimin njerëzor, veçanërisht në botën e punës. Për të arritur këtë, ai kryen veprimtari kërkimore dhe trajnon vendim-marrësit dhe personelin që punon për zhvillimin lokal.



Në Shqipëri, IDEASS është një iniciativë e programit PASARP (Programi i Aktiviteteve në Mbështetje të Qarqeve dhe Prefekturave Shqiptare), realizuar nga IFAD/UNOPS me fondet e bashkëpunimit italian.